



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 16/2022 (JR)  
Nr. 16/2 regj.

Tiranë, më 4.07.2024

**SHPALLJE  
E  
NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË DHOMË KËSHILLIMI**

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar se **ditën e mërkurë, datë 11.09.2024, ora 10:00**, do të gjykohet në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh çështja e Juridiksionit të Rivlerësimit me numër regjistri (JR) 16/2022, datë 17.03.2022, për ankimin e subjektit të rivlerësimit Elina Kombi kundër vendimit nr. 507, datë 03.02.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Seanca në dhomë këshillimi do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykses përbëhet nga gjyqtarët:

**Kryesues i Trupit Gjykses**  
**Relatore e Çështjes**  
**Gjyqtare**  
**Gjyqtare**  
**Gjyqtare**

**Sokol Çomo**  
**Natasha Mulaj**  
**Albana Shtylla**  
**Mimoza Tasi**  
**Rezarta Schuetz**

Bazuar në nenin 49 pika 2 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrimet me shkrim, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim.

Bazuar në nenin 482 paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu dhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

**KRYESUES I TRUPIT GJYKUES**  
**GJYQTAR**

**SOKOL COMO**

